



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1279, datë 20.05.2010

Per “Fillimin e procedimit administrativ per zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni midis Sipermarresve¹ Alternative dhe Albtelcom sh.a, AMC sh.a, Vodafone sh.a”.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.05.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Zgjidhje mosmarreveshje Interkoneksioni midis Primo sh.p.k, Nisatel sh.p.k, ATN sh.p.k, IT-Tel sh.p.k, Mobik sh.p.k, Tele-Group sh.p.k, Enada Online sh.p.k, Telekom Postriba sh.p.k, Telekom Dova sh.p.k dhe AMC sh.a, Vodafone Albania sh.a, Albtelcom sh.a.”

BAZA LIGJORE

1. Neni 120, i Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”
2. Nenet 66-104 te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (KPrA).

¹ Primo sh.p.k, Nisatel sh.p.k, ATN sh.p.k, IT-Tel sh.p.k, Mobik sh.p.k, Tele-Group sh.p.k, Enada Online sh.p.k

3. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 416, date 07.12.2007.
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

V Ë R E N :

1. AKEP me shkresen nr.190/2 prot, date 20.01.2010, i eshte drejtuar Albtelecom sh.a duke i kerkuar informacion ne lidhje me ankesat e parashtruara nga Nisatel, Enada Online, Sabatel, dhe Ru-tel per trafikun e percjelle dhe tranzituar nga Albtelecom. Gjithashtu, kjo shkrese citon kerkese per informacion te detajuar nga operatoret e sipershenuar duke perfshire tregues te perqindjes se trafikut pa CLI etj.
2. Albtelecom me shkresen nr. 427 prot, date 03.02.2010 i eshte pergjigjur kerkeses se AKEP, ne lidhje me ankesat e operatoreve duke dhene informacion se ne funksion te garantimit te sherbimit te tranzitimit sipas standarteve dhe cilesive te parashikuara ne MI dhe ne parashikimet e RIO-s, ka kryer verifikimin perkates teknik, duke kontrolluar menjehere situaten ne qarqet interkoneksionit me rrjetet mobile.
3. Albtelecom, me shkresat nr. 8667 dhe nr.8667/1, date 09.12.2009 drejtuar Vodafone dhe AMC, ben me dije operatoret celulare, per ankesat ne lidhje me realizimin e trafikut nga sipermarrsit alternative Sabatel sh.p.k, Ru-Tel sh.p.k, Sin-Tel sh.p.k, Tele Co & Construction dhe Telekom Postriba sh.p.k drejt rrjeteve celulare, duke kerkuar shqyrtimin e ankesave dhe gjetjen e nje zgjidhje teknike. Eshte i nevojshem shtimi i kapaciteteve ne qarqet e interkoneksionit me AMC dhe Vodafone, per trafikun e tranzituar nepermjet Albtelecom, midis operatoreve Alternative, Vodafone dhe AMC, bazuar ne Marrveshjevet respektive te Interkoneksionit, i eshte drejtuar Vodafone me shkresen nr. 8711 prot, date 10.12.2009 “*Kerkese per shtese kapaciteti per tranzitimin e thirrjeve te Sipermarresve Alternative drejt Vodafone Albania sh.a*” si dhe AMC-se me shkresen nr. 8712 prot, date 10.12.2009 “*Kerkese per aktivizim e E1 te qarkut te interkoneksionit*”, duke qene se nje nga E1 e percaktuar nga Marreveshje per kete qellim, nuk aktivizohet ne menyre eficente nga ana e AMC.

4. Albtelecom thekson se per keto shkresa nuk ka marre asnje pergjigje zyrtare nga Vodafon, dhe AMC.
5. Albtelecom sh.a sqaron se, AMC ka paraqitur ankesen, nr.7820 prot, date 02.11.2009, lidhur me terminimin e trafikut nga Nisatel drejt AMC, me CLI te modifikuar. Per kete shkelje i eshte derguar Nisatel nje shkrese “Njoftim per shkelje” nr. 8088 prot, date 12.11.2009, AMC nuk ka ngritur me asnje pretendim lidhur me Nisatel.
6. Me shkresen nr. 190/4 prot, date 01.03.2010 Albtelecom i eshte drejtuar AKEP me nje informacion te detajuar ne vijim te komunikimit te dates 03.02.2010 duke i vene ne dispozicion te dhena te Albtelecom, per thirrjet e OA te derguara per terminim ne Albtelcom, per tranzitim ne operatoret celulare apo operatoret te tjere fiks:
 - ASR (Answer/Seizure Ratio) niveli i thirrjeve te sukseshsme pjestuar me numrin total te perpjekjeve per thirrje, varion nga 8% ne 52%;
 - CLI e thirrjeve te OA, nje numer i vogel (deri ne 1%) jane pa CLI, ndersa numri i thirrjeve me CLI te modifikuar varion nga 16% deri ne 57%;
7. Enada Online sh.p.k i eshte drejtuar AKEP me ankesen nr. 12/4 prot, date 12.04.2010, per nje zgjidhje ligjore te mosmarreshjeve te saj me operatoret FNT, duke cituar se problematika e saj, per abonentet dhe per sipermarrien eshte per nje periudhe 6 mujore, dhe si rrjedhoje 200 abonente kane bere prishje te njeanshme te kontrates.
8. IT-Tel sh.p.k, me shkresen nr.6/1 prot, date 03.02.2010, drejtuar Albtelecom, per dijeni AMC dhe AKEP, “ *Pergjigje njoftimit per shkelje te MF*”, sqaron se nuk ka patur ankesa per shkelje nga Albtelecom, Vodafone dhe operatoret alternative, ndersa me AMC problemi eshte i ndryshem dhe nuk ka lidhje me fshehjen apo tjetersimin me qellim te CLI.
IT-Tel me shkresen nr. nr. 6/2 prot, date 08.02.2010, ka kerkuar bashkepunimin dhe angazhimin e specialisteve te Vodafone dhe AMC per te zgjidhur problemet teknike ne rrjetet perkatese ne menyre qe tranzitimi i thirrjeve nga IT-Tel drejt rrjetit AMC te realizohet me CLI.
9. Primo Communications sh.p.k i eshte drejtuar AKEP me shkresen nr.094 prot, date 01.02.2010, “ *Mbi zbatimin e MI mes Primo C dhe AMC*”, per nderhyrje administrative te AKEP per te zgjidhur mosmarreshjen mes paleve mbi kerkesen e Primo C, per shtimin e kapaciteteve E1 nga AMC. Me kete shkrese, Primo C sqaron, se me daten 24.07.2009, i eshte drejtuar AMC me nje kerkese zyrtare per te rritur kapacitetin e interkoneksionit edhe me nje E1.
Ndersa, AMC sh.a i eshte pergjigjur Primo C me shkresen nr.539/1 prot, date 27.10.2009, duke i njoftuar pamundesine teknike, per ofrim te kapacitetit shtese per shkak te hapesirave te kufizuara si dhe nje *upgrade* te gjere te *switch*-eve.

10. Nisatel sh.p.k, me shkresen nr.629, date 17.02.2010 “*Mbi procedurat e ankesses per abuzimin me poziten dominuese ne treg*” i eshte drejtuar AKEP duke e bere me dije, per situaten e vazhdueshme problematike te interkoneksionit me Vodafone sh.a.
- Me shkresen nr. 869 prot, date 04.03.2010 Nisatel sh.p.k i eshte drejtuar AKEP per zgjidhjen e mosmarreveshjes mbi MI-ne mes Nisatel dhe Vodafone.
Sipas Nisatel, veshtiresite per realizimin e kesaj marreveshjeje konsistojne ne kushtin e vendosur nga Vodafone per heqien e lidhjes egzistuese tranzit nepermjet Altelecomit dhe ne pamjaftueshmerine e kapacitetit prej vetem 1xE1, qe Vodafone ofron per lidhjen direkte.
 - Me shkresen e dates 29.03.2010 “*Mbi terminimin e thirrjeve drejt Vodafone*”, Nisatel serish ka trajtuar problematiken e krijuar ne vazhdimesi me Vodafone duke rikerkuar nderhyrjen e AKEP per zgjidhjen e mosmarreveshjes.
Nisatel thekson se, mosveprimi nga ana e Altelecom dhe Vodafone, ka cuar ne perkeqesimin e skajshem te nivelit te sherbimit te Nisatel.
11. ATN sh.p.k me shkresen nr. 02/1 prot, date 08.02.2010 i ben me dije AKEP se i eshte drejtuar AMC sh.a me date 12.12.2009, per te lidhur marreveshje interkoneksioni direkte, por nga pala tjetere nuk ka asnje pergjigje, per kete arsye nevojitet nderhyrje administrative e AKEP per te zgjidhur mosmarreveshjen mes tyre. Ne kushtet kur nga AMC sh.a nuk eshte kthyer pergjigje, AKEP me shkresen nr.487/1prot, date 09.03.2010 “*Kerkese per zgjidhje mosmarreveshje*” i ka kerkuar operatorit AMC, te paraqese me shkrim arsyet perse nuk eshte arritur marreveshja e interkoneksionit mes te dy paleve, duke bashkengjitur dokumentacionin perkates, deri me date 16.03.2010. AMC sh.a i eshte pergjigjur kesaj kerkese me shkresen nr. 570/1, date 12.03.2010 “*Informacion mbi zgjidhje mosmarreveshje*”, duke i bashkengjitur praktiken e komunikimit shkresor nder vite me ATN.
12. Tele-Group me shkresen nr.23/2 prot, date 17.02.2010, “*Ankese per veshtiresi e vijueshmerine e trafikut*” njofton Altelecom dhe AKEP-in per nderprerjet e herepashershme te transmetimit te sinjalit. Serish me shkresen nr. 25 prot, date 18.03.2010 Tele-Group i eshte drejtuar Altelecom dhe AKEP me ankese per problemet e ngritura ne shkresen e dates 17.02.2010, duke kerkuar marrjen e masave per eliminimin e problemeve.
13. Mobik sh.p.k, me shkresen nr. 21/2010 prot, date 06.04.2010 “*Ankese per moslidhjen e marreveshjes se Interkoneksionit me Vodafone sh.a*” dhe me shkresen nr.22/2010 prot, date 06.04.2010 “*Ankese per moslidhjen e marreveshjes se Interkoneksionit me AMC*” i eshte drejtuar AKEP per zgjidhjen e mosmarreveshjes lidhur me refuzimin e dy FNT-ve per lidhjen e Marreveshjes se Interkoneksionit. Bashkengjitur ankesses se sipercituar Mobik sh.p.k, ka vendosur te gjitha dokumentat shkresor qe provojne kerkesat e saj te herepashershme per lidhje te MI dhe dhenie te 10 kapaciteteve E1 me Vodafone dhe AMC. Me shkresen nr. 1483/1, date 19.04.2010” Mbi ankesen e operatorit Mobik sh.p.k, per moslidhjen e MI”, Vodafone Albania i eshte pergjigjur AKEP dhe per dijeni

Mobik, ne lidhje me ankesen duke sqaruar, se Mobik nuk ka ezauruar fazen e negociatave mes paleve per lidhjen e MI, si dhe arsyeton pamundesine teknike, per te lidhur pika te reja te interkoneksionit, deri na fund te marsit 2010, per shkak te punimeve ne rrjet, si dhe kerkesa per kapacitet fillestar per 10 E1 eshte ne kundershtim me ORI te Vodafone. Nderkohe qe AMC sh.a, nuk rezulton te kete depozituar ne AKEP ndonje shkrese formale lidhur me ceshtjen me siper.

14. AMC me shkresen nr.prot.6857/4, date 20.01.2010 dhe Vodafone Albania me shkresen CEO/0005/EXH, ne komentet e tyre per analizen e tregut celular dhe ceshtjen e terminimit te thirrjeve hyrese nderkombetare kane derguar te dhena, per perqindje te larte te thirrjeve me CLI te modifikuar dhe nivel te larte te thirrjeve jo te suksesshme.
15. Palet megjithe negociatat dhe sqarimet e dhena kane mosmarveshje ne lidhje me zbatimin e marveshjeve te interkoneksionit te lidhur midis tyre, apo ne lidhje me mos-realizimin e interkoneksionit direkt me operatoret celulare. Nje numer i madh OA te interkonektuar me Albtelcom ankohen per cilesine e trafikut te percejllje drejt operateve celulare, AMC dhe Vodafone, pasi shpesh here nuk arrihet te realizohen thirrjet drejt ketyre rrjeteve (madje dhe thirrjet ne kahun e kundert). Nga informacioni i Albtelcom rezulton se, kapacitetet e interkoneksionit midis Albtelcom, AMC dhe Vodafone, per trafikun e tranzituar nga/drejt OA nuk eshte i mjaftueshem per te realizuar sasine e trafikut dhe cilesine e MI.
16. Albtelcom ka bere kerkese ne baze te parashikimeve te MI me AMC dhe Vodafone per shtim te E1, apo venie ne perdorim te E1-ve ekzistuese, qe nuk perdoren, por ende nuk ka marre pergjigje nga AMC dhe Vodafone.
17. Nga pretendimet e paleve, kerkesat dhe argumentet e tyre vihet re, se problemet apo mosmarveshjet midis OC dhe OA jane te njejtat ne thelb dhe kane lidhje dhe me tranzitimin e thirrjeve ne rrjetin Albtelcom drejt OC. Zgjidhja e mosmarveshjeve mund te kryhet ne baze te kerkeses, se nje operatori apo me iniciativen e AKEP.
18. Nga pretendimet e paleve, kerkesat dhe argumentet e tyre vihet re, se problemet apo mosmarveshjet midis OC dhe OA jane te njejtat ne thelb dhe kane lidhje dhe me tranzitimin e thirrjeve ne rrjetin e Albtelcom drejt OC. Zgjidhja e mosmarveshjeve mund te kryhet ne baze te kerkeses se nje operatori, apo me iniciativen e AKEP.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e zgjidhjes se mosmarveshjes se interkoneksionit te sipërmarrësve Primo sh.p.k, Nisatel sh.p.k, ATN sh.p.k, IT-Tel sh.p.k, Mobik sh.p.k, Tele-Group sh.p.k, Enada Online sh.p.k, Telekom Postriba sh.p.k, Telekom Dova sh.p.k, interesat e perdoruesit te rrjeteve te tyre dhe rregullimin e marredhenieve ne treg, bazuar

në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të filloje procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarresve Primo sh.p.k, Nisatel sh.p.k, ATN sh.p.k, IT-Tel sh.p.k, Mobik sh.p.k, Tele-Group sh.p.k, Enada Online sh.p.k, dhe **AMC sh.a, Vodafone Albania sh.a, Albtelcom sh.a.**
2. Palet deri me datë 07.06.2010, të depozitohen në AKEP pretendimet me shkrim.
3. Për ndjekjen e këtij procedimi administrativ, ngarkohet Drejtoria e Rregullimit Ekonomik dhe Drejtoria Juridike.
4. Të njoftohen palët e interesuara për këtë vendim.
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.gov.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**